



Prishtinë, 14 tetor 2016
Kodi i ZRRE-së: V_852_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 15 , dhe Dispozitat e Nenit 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084):
- Dispozitat e Nenit 36 Paragrafi 2 të Ligjit për Energjinë elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT Sh.A) të datës 08.09.2016 për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit: Procedura e Rregullave të Tregut për Ndërrimin e Furnizuesit – tash “**Rregulla për ndërrimin e Furnizuesit**”,

në seancën e mbajtur me datë 14.10.2016, nxori këtë:

VENDIM

I. MIRATOHET dokumenti **Rregulla për ndërrimin e Furnizuesit**

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 08 shtator 2016 ka pranuar kërkesën për aprovim të dokumentit Procedura e Rregullave të Tregut për Ndërrimin e Furnizuesit - tash **Rregulla për ndërrimin e Furnizuesit** nga KOSTT SH.A. Dokumenti është zhvilluar nga KOSTT duke u bazuar në Rregullat e Tregut të aprovuara nga ZRRE.
- KOSTT më parë ka dërguar dokumentin për shqyrtim fillimisht me 24 korrik 2015 si procedurë të Rregullave të Tregut. ZRRE ka dhënë komentet e veta në formë të shkruar të cilat komente janë përfshirë, apo janë sqaruar çështjet e ngritura. Më vonë dokumenti i është dërguar për komentim palëve të interesuara, Sekretariatit të komunitetit të energjisë dhe konsulencës, dhe pas përfshirjes së komenteve të arsyeshme nga të gjitha palët, është dërguar serish me datë 03.06.2016, si version i ri për aprovim në ZRRE.
- Pas aprovimit të ligjeve të reja të energjisë, e bazuar në Nenin 36 Paragrafi 2 të Ligjit për Energjinë elektrike ku thuhet “*Rregullatori miraton rregullat për ndërrim të furnizuesit*”, ZRRE e ka përshtatur dokumentin në formën si: **Rregulla për ndërrimin e Furnizuesit**. Pas vlerësimit dhe përshtatjes së dokumentit, ZRRE konsideron se dokumenti i përmbush kriteret për miratim, dhe duke marrë parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje të vendimit, ka



vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi duke miratuar dokumentin **Rregulla për ndërrimin e Furnizuesit**.

II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimit i bashkëngjitet dokumenti: ***Rregulla për ndërrimin e Furnizuesit***

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së

Krenar Bujupi, u.d. kryesuesit

Arsim Janova, anëtar

Qemajl Mustafa, anëtar

Besim Sejfić, anëtar